



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura IV**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 81

Prishtinë, më 10 qershor 2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S 2

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

**Në mbledhje morën pjesë:** Arben Gashi, Mufera Shinik, Behar Selimi, Ardian Gjini, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

**Mungoi:** Arsim Bajrami.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Hajredin Kuçi dhe Vigan Qorrolli – MD; Blerta Bejtullahu-EUSR/EVO; Hara Orana – Bota Sot; Sylë Ahmeti – Kosova Sot; Vlera Nushi – UNMIK; Donik Qerimi – MD; Resmije Halilaj, Xhyllferie Gashi dhe Violetë Zogaj – studentë, AAB; Artan Canhasi – EULEX; Petrit Hysaj – OSBE; ...Perteshi- QKSS; Lendita Heta dhe Burim Kadrijaj – Kolegji AAB; Sahadete Zogaj – Kosova Pres; Vlora Marmullakaj-EULEX; Lumniye Beka – Kosova Info; Bajram Gecaj – USEP; Gentiana Begolli- Pustina – RTK; Visar Smajlaj – ekspert; Doresa Halili – praktikante; Fidan Rama – Tribuna, Arta Berisha – TVA; Zijadin Gashi- RFE dhe Burbuqe Berisha – praktikantë.

**Nga stafi i Komisionit për Legjislacion:** Idriz Tahiri dhe Visar Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi,** Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.4.2013;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të planit të zbatimit për këtë marrëveshje;
4. Të ndryshme.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari** propozoi që në pikën të ndryshme, të futet edhe shqyrtimi i Projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.04.2013**

**Kryetari** konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 29.04.2013, pa vërejtje.

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të planit të zbatimit për këtë marrëveshje**

**Kryetari** – Tha se ky Projektligj është mjaft i shkurtër dhe ka vetëm 3 nene. Ai tha se neni 1 përcakton qëllimin e këtij Projektligji, neni 2 ka të bëjë me fushëveprimin e tij dhe neni 3, hyrjen në fuqi të tij. Shprehu shqetësimet e tij lidhur me këtë Projektligj për problemet përmbajtësore, si dhe sugjeroi mos të ratifikohet plani i zbatimit, i cili është një plan operacional. Ai shprehu dyshimet e tij, sepse ky dokument mund të ndryshohet dhe të plotësohet. Si Kuvend, duhet të kemi parasysh dhe mos ta ratifikojnë këtë plan, si dhe duhet të njoftohemi se cilat ligje duhet ndryshuar dhe çfarë parasheh Ligji për amnistinë, që është objekt i tij, cilat lloje të veprave penale duhet të amnistohen. Ju drejtua zëvendëskryeministrit, z. Hajredin Kuçi, që të japë sqarimet se pse duhet apo nuk duhet që plani i zbatimit të jetë pjesë e ratifikimit.

**Hajredin Kuçi** – Duke folur për marrëveshjen, tha se kjo marrëveshje është nënshkruar nga dy qeveritë, me ndërmjetësimin e zonjës Ashton dhe qëllimi i kësaj marrëveshjeje është ndërprerja e prezencës së strukturave të Serbisë në Kosovë, si dhe qytetarët serbë që të inkuadrohen në institucionet e Kosovës. Ai tha se do të ketë edhe marrëveshje të tjera deri tek traktati i paqes. E vetmja parti, e cila nuk ka qenë e informuar me procesin, është Vetëvendosja. Ai dha shpjegime për përmbajtjen e marrëveshjes, për të cilën tha se ka 4 fusha. Fusha e parë ka të bëjë me asociacionin e komunave. U pajtuam me palën serbe që kjo të ndodhë pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale në tërë territorin e Kosovës. Çështja e dytë, që është më e ndjeshme, është ajo e drejtësisë, që i prek disa segmente. Segmenti i parë është që më 17 qershor, Serbia do të marrë vendimin që të pushojë së funksionuari gjykatat në veriun e Kosovës. Çështja e tretë i përket pajtimit për hapje të konkursit për vende të reja pune për qytetarët dhe prokurorët serbë dhe për policinë. Pjesëtarët e Policisë së Kosovës, do të vazhdojnë të punojnë edhe më tutje, por me kusht që më 15 qershor, duhet të deklarohen se nuk do të marrin dy paga. Qeveria e Serbisë do të marrë vendim që mos t'i financojë këto struktura. Çështja e katërt ka të bëjë me zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet do të mbahen njëkohësisht në gjithë territorin e Kosovës. Tregoi se kanë formuar 4

grupe punuese, që të kryejnë punën e tyre lidhur me Ligjin për amnistinë. Ky ligj nuk është vetëm i një territori apo një grupi etnik. Ky ligj do të përmbajë dispozitat që përfshijnë nenet e Kodit penal. Sa i përket planit të zbatimit, Qeveria e Kosovës është e mendimit se duhet të ratifikohet dhe se jemi të pajtimit që kjo marrëveshje të ratifikohet sa më shpejt.

**Kryetari** – Tha se janë të pajtimit që marrëveshja të ratifikohet dhe se planin e veprimit ta trajtojmë si plan operacion, mirëpo ka një dallim konceptual dhe se nuk duhet lejuar hapësirë për interpretim, sepse mund të prodhojë pasoja të mëdha.

**Behar Selimi** – Duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolësve, tha se nuk ka shqetësime të mëdha rreth marrëveshjes, por shqetësimi i vetëm është zbatimi sa më parë i kësaj marrëveshjeje, ndërsa sa i përket deklarimit lidhur me planin e zbatimit, nuk është problem që sot të deklarohemi. Fusha e legjislacionit ka pasur mjaft keqkuptime në opinion, interpretime dhe deklarata nga pala serbe. Ndërsa, Ligji për amnisti, nuk e sheh lirim të kriminelëve, vrasësve. Qytetarët duhet njoftuar se kemi dy lloje të strukturave, legale dhe kriminale dhe se ato duhet trajtuar politikisht, sepse kjo është një mënyrë e zgjidhjes së problemeve.

**Haki Demolli** – Iu drejtua zëvendëskryeministrit me pyetjen: Pse është emëruar si Ligji i marrëveshjes së parë, pasi që ju thatë se do të kemi edhe marrëveshje të tjera, sa marrëveshje do të kemi dhe sa do të zgjasë ky proces? Ai, po ashtu, shprehu shqetësimet e tij lidhur me dallimet në tri gjuhët, duke theksuar se marrëveshja duhet të jetë e përkthyer në nivel të lartë. Shembull mori paragrafin 9 në gjuhën angleze dhe serbe, ndërsa ka fjalë të tekstit që në gjuhën shqipe mungojnë. Pika 6 thotë se asociacioni ka vend në organet lokale dhe këshillëdhënëse, kurse në gjuhën shqipe thotë se do të ketë një përfaqësues. Pika 1 në gjuhën serbe është dashur të jetë “osnovana” dhe është “uspostavlena”. Sa i përket çështjes që u përmend nga zëvendëskryeministri, lidhur me pikën 8, që ishte ofrimi i vendeve të punës, pyeti: Çka nëse ata nuk pranojnë? Në fund e përmendi edhe pikën 10, që ka të bëjë me panelin e Gjykatës së Apelit, ku thuhet se ky panel do të formohet dhe do të jetë komplet për të gjitha komunat me shumicë serbe. Pyeti: A janë specifikuar çështjet se cilat detyra do të jenë objekt i këtij paneli?

**Albulena Haxhiu** - Tha se si subjekt politik i kanë shprehur shqetësimet e tyre lidhur me këtë marrëveshje, por Komisioni për Legjislacion ka për detyrë ta verifikojë bazën kushtetuese të marrëveshjes. Ajo tha se përmbajtja e marrëveshjes është në kundërshtim me praktikën e hartimit të legjislacionit, sepse ky projektligj, si i tillë, objektin kryesor të trajtimit e ka të kufizuar, ndërsa sa i përket fushëveprimit, ceket OSBE, Bashkimi Evropian dhe pyetja është se ku gjendet baza juridike për shenjë të kompetencës së OSBE-së dhe Bashkimit Evropian. Dua të sqaroj se kjo marrëveshje ka shkelje kushtetuese dhe se kjo marrëveshje Thaçi-Daqiq, është e dëmshme për Sovranitetin dhe ndërtimin e shtetit të Kosovës. Nëse vjen deri tek ratifikimi i kësaj marrëveshjeje, atëherë hidhen themelet e autonomisë territoriale etnike serbe brenda Kosovës. Ajo tha se krijimi i fondit zhvillimor bie ndesh me nenin 120. 1 të Kushtetutës së Kosovës, po ashtu bien ndesh edhe me Ligjin për financat publike, sepse ato nuk kalojnë procedurat e miratimit. Neni 18. 1, në të cilin thuhet se duhet të jepet llogari e vetme që menaxhohen mjetet financiare të Kosovës. Ajo më tutje tha se shqetësim tjetër i saj është asociacioni i komunave, ku nga pika 1-6 e kësaj marrëveshjeje, bien ndesh me Kushtetutën, ku asociacionit i jepen kompetenca të tilla që konsistojnë një trup politik me organizim institucional të ndryshëm nga pjesa tjetër e vendit. Rregullimi duhet të bëhet ashtu që mos t'i jepen të drejta vetëm një

komuniteti etnik. Strukturat e kësaj marrëveshjeje po legalizohen dhe po amnistohen bartësit kundërkushtetues dhe të paligjshëm. Kemi strukturat paralele që përfshihen në këtë marrëveshje, që është në kundërshtim me nenin 125 të Kushtetutës. Po ashtu, edhe në aspektin e sigurisë, policisë dhe drejtësisë, po fillojnë çarjet e para të sistemit shtetëror. Kjo është një mënyrë e krijimit të dy hapësirave të ndryshme të organizimit shtetëror. Çka është më skandaloze që po amnistohen strukturat kriminale. Sa i përket gjyqësorit, në pikën 10 të marrëveshjes, që thotë se do të krijohet një njësi të veçantë e Gjykatës së Apelit, i cili do të vendoset përhershëm në veriun e vendit tonë, mirëpo kryesuesi i Këshillit Gjyqësor i ka shprehur shqetësimet e tij lidhur me këtë, sepse Kushtetuta nuk e parasheh njësinë e Gjykatës së Apelit në veri. Sa i përket zgjedhjeve, janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse në pikën 11 i jep kompetencë OSBE-së, të organizojë zgjedhjet dhe është shkelje e nenit 139 të Kushtetutës që i jep autorizim KQZ-së, si të vetmit autoritet, të organizojë zgjedhjet. Adresoi pyetje për zv. kryeministrin: Sipas kornizës ligjore, thuhet se asociacioni do të harmonizohet apo do të zbatohet kompetencat e veta në bazë të ligjit të Kosovës dhe atij kushtetues, cili do të jetë kontrolli kushtetues mbi asociacionin, ku thuhet se shpërbërja e këtij asociacioni do të bëhet me 2/3 e anëtarëve të tij ?

**Gëzim Kelmendi** - Duke folur për Ligjin për amnisti, pyeti: Për cilën kohë bëhet fjalë, para luftës apo pas luftës, sepse kohëve të fundit shumë ushtarë të UÇK-së ndodhen nën hetime?

**Halit Krasniqi** – Duke u ndërlidhur me parafolesit, ai tha se një nga shqetësimet është mospërputhshmëria e teksteve në tri gjuhët dhe hartuesit të kenë kujdes të veçantë dhe t'i përshtatin formulimet. Ai tha se është mjaft brengosëse çështja e amnistisë, konceptimi se si bëhet ajo dhe natyrisht është dhe shqetësim i opinionit. Sa i përket normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, duhet të bëhet sa më shpejt. Ai tha se do të ndalet tek formulimi, ku thuhet se Serbia do të fillojë mbylljen e strukturave të saj të sigurisë në Kosovë, por mendoj se kjo do ishte më mirë që të ndryshohet, sepse mbyllja do të thotë hermetizmin e tyre dhe hapjen kurdo që të jetë e nevojshme. Sa i përket policisë, është e rëndësishme që të gjithë pjesëtarët që do të fillojnë punën në Policinë e Kosovës, automatikisht duhet të pranojnë edhe ligjet e Kosovës.

**Armend Zemaj** – Tha se e dimë mandatin dhe detyrat që i ka Komisioni për Legjislacion. Mendoj se marrëveshja duhet të ratifikohet përmes ligjit të sponsorizuar nga Qeveria e Kosovës. Sa i përket skepticizmit dhe dallimeve, ato janë normale dhe se nga fillimi ka munguar transparenca dhe tani me këtë marrëveshje po fillon zbatimi i plotë i saj, ku nënkupton edhe marrëveshjet e tjera të arritura deri më tani, ku Kuvendi nuk është njoftuar fare. Ne duhet të dalim nga kjo gjendje dhe ajo pjesë e Kosovës përgjithmonë t'i nënshtrohet rregullit të Republikës së Kosovës, integritetit të vendit. Besoj që kjo do të realizohet. Kam dyshim që në Ligjin për amnistinë do të amnistohen të gjitha strukturat në Kosovë, ato kriminale dhe ato parapolitike të partive politike. Pyeti: Çka do të përfshijë ky ligj, dhe e dyta, kategoritë që kohë më parë i kemi miratuar në Kodin penal? Çështja e dytë, ne kemi pasur një rezolutë nga Këshilli i Evropës këtë vit, ku obligon Serbinë që të dekonspirojë 700 pjesëtarë të UDB-së serbe që veprojnë në Kosovë. Dhe krejt në fund, pse nuk është përfshirë në këto bisedime Kuvendi apo ndonjë komision, sidomos komisionet kryesore?

**Ardian Gjini** – Duke folur për projektligjin, tha se brengë e tij është çështja e trajtimit të Projektligjit për ratifikim, e jo marrëveshja, po ashtu edhe çështja e gjuhës. Pyetja ime është se në versionin në gjuhën angleze, që është edhe versioni i punës përmes të cilit ne mbajmë përgjegjësi për garantimin e kësaj marrëveshjeje, a duhet pasur një paragraf i cili e sqaron këtë temë? Çështja e dytë, është aspekti total i kësaj marrëveshjeje, që ne si Aleancë e kemi mbështetur këtë dialog dhe vazhdojmë ta mbështesim. Mendoj se qëllimi i strategjisë është integrimi në Bashkimin Evropian dhe në NATO, ndërsa pjesa tjetër është mirëqenia e qytetarëve. Te çështja e amnistisë, nuk është çështja se a amnistohen kriminelët serbë në veri, por a amnistohet cilido kriminel në Kosovë.

**Kryetari** – Tha se pajtohet me parafolësit, lidhur me mospërputhjen e tekstit në të tri gjuhët. Teksti duhet të harmonizohet që të kemi një tekst final në të gjitha versionet, dhe se plani i zbatimit mos të jetë pjesë e Ligjit të ratifikimit të marrëveshjes.

**Jasmina Zhivković** – Në fjalën e saj, tha se SLS-ja parimisht e përkrah marrëveshjen që është në dobi të qytetarëve, por mua personalisht më pengon ndarja e serbëve në veri dhe të serbëve në jug. Megjithatë, besoj se kjo marrëveshje sjell normalizimin e marrëdhënieve të të dy vendeve. Mendoj se kjo marrëveshje nuk ka të bëjë vetëm me veriun e Kosovës, por edhe për qytetarët që jetojnë në jug. Pyeti për strukturat e sigurisë dhe të gjyqësisë. Sipas këtij plani, është thënë se do t'u ofrohet vend serbëve në këto struktura, e pasi që Kosova është e gatshme të ofrojë 100 deri 150 vende, çka do të bëhet edhe me 700 familje tjera? Kërkoj sqarim se ky numër a ka të bëjë me veriun dhe jugun apo si është menduar?

**Hajredin Kuçi** – Duke u përgjigjur në pyetjet e deputetëve, tha se do të punojnë shumë që të kenë një konsensus të gjerë politik, sepse për një marrëveshje të tillë kërkohen 2/3 e Kuvendit. Ripërsëriti qëndrimin e tij se Projektligji për amnisti është propozuar nga ai që nga prilli i vitit 2011 dhe se qëllimi i këtij projektligji është që amnistia të përfshijë vepra të caktuara, dhe jo një etnitet apo një pjesë të territorit, por çdo vepër e amnistuar do të jetë për çdo rast, respektivisht vepër dhe kryerës, pa dallime etnie dhe në çdo pjesë të territorit të Republikës së Kosovës.

Ai tha se nuk do të ketë amnisti për kriminelë, por vetëm për ata që kanë punuar në administratën ilegale në veri. Shtoi se Kosova qysh në vitin 1999, ka humbur shansin e amnistisë në marrëveshjen e Rambujesë, të paraparë edhe në Kornizën kushtetuese, por edhe në vitin 2008, nuk na është lejuar.

Duke u përgjigjur në pyetjen e z. Demolli, tha se përkufizimi nuk është korrekt. Policia do të reflektojë strukturën etnike të komunave ku shërbejnë, ndërsa për çështjen e ofrimit të vendeve të punës, do të bëhen nëpërmjet procedurave dhe me konkurs, do të caktohen se për sa vende ka nevojë. Dialogu nuk do të përfundojë deri tek traktati i paqes. Te çështja e komunave, kryetari i gjykatës themelore vendos, ndërsa gjyqtarët do të caktohen sipas natyrës së rasteve.

Duke u përgjigjur në pyetjen znj. Haxhiu, tha se ka arsytet politike që mos ta përkrahin këtë marrëveshje, mirëpo nuk ka arsye kushtetuese. Asociacioni i komunave është bërë sipas ligjit dhe Kushtetutës, ka qenë sistemi unik edhe në polici edhe në drejtësi.

Duke u përgjigjur në pyetjen z. Kelmendi, sqaroi se nëpërmjet kësaj amnistie, një kategori e personave me emër do të identifikohen, ndërsa Ligji për amnistinë ende nuk ka përfunduar.

Duke u përgjigjur në pyetjen e z. Zemaj lidhur me transparencën në bisedime, ku tha se nuk mund të pajtohet me dy çështje, e para nuk ka pasur ndonjë takim që nuk e kemi njoftuar liderin e partisë tuaj politike dhe shefin e grupit parlamentar, dhe nuk ka marrëveshje që është

nënshkruar, pa konsultime paraprake. Në Kuvend, 8 herë ka pasur debat lidhur me këtë çështje dhe marrëveshja është miratuar me 89 vota.

**Armend Zemaj** – Sqaroi qëndrimin e tij se kur është fjala te transparenca, unë e pata fjalën te Kuvendi, e jo te partia politike.

**Albulena Haxhiu** – Në fjalën e saj të serishme, tha se për çdo pikë që e ka përmendur, është në kundërshtim me Kushtetutën dhe do ta dërgojnë ne Gjykatën Kushtetuese, nëse vjen deri tek ratifikimi i kësaj marrëveshjeje.

**Kryetari**- Ishte i mendimit se nuk duhet të jetë pjesë e marrëveshjes, plani i zbatimit. Si Komision, duhet të konsultohemi dhe mos të aprovojme një ligj, që ka 2 anekse, e që kanë mospërshtatje.

**Behar Selimi** - Mendoj se ne mund ta votojmë projektligjin, me një amendament i cili e fuqizon tekstin në gjuhën angleze, si gjuhë zyrtare të saj, si dhe kërkohet që të bëhet një përkthim i mirë.

**Ardian Gjini** – Në fjalën e tij të serishme, tha se lidhur me ratifikim e marrëveshjes na duhet konsensus sa më i gjerë dhe ky konsensus duhet të reflektohet këtu, sepse nëse nuk ka reflektim të konsensusit në Komision, do të jetë shumë vështirë të ketë konsensus në Seancën plenare. Propozoi që të takohen më 11. 06. 2013, për sqarim të këtyre temave, sepse nuk mund të votojë për ose kundër kësaj marrëveshjeje dhe planit të veprimit me këto dilema.

Komisioni për Legjislacion, me një votë kundër, nxori këtë

### **Përfundim**

*Mbledhja e radhës së Komisionit për Legjislacion, lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të planit të zbatimit, të mbahet më 11. 06. 2013.*

## **4. Të ndryshme**

### **a. Projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës**

Komisioni për Legjislacion, duke vepruar në pajtim me vendimin e Kuvendit nr. 04-V-554, i datës 19 mars 2013, e shqyrtoi Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë

### **R e k o m n d i m**

1. Të mos miratohet Projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës.

2. Projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, t'i kthehet propozuesit, që të harmonizohet me Kushtetutën dhe me nenin 5, të Ligjit nr. 04/L-115, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Kryetari i Komisionit

E përgatiti:  
Stafi Mbështetës i Komisionit.

---

**Arben Gashi**